



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 06, datë 12.12.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “NDËRTIMI I BURIMIT TË RI GJENERUES TË ENERGJISË, HIDROCENTRALIT “JETONI”, NË PËRROIN E TUÇEPIT, DEGË E LUMIT DRIN I ZI”, BASHKIA BULQIZË, QARKU DIBËR”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Gerti” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Jetoni”, në përroin e Tuçepit, degë e lumit Drin i Zi”, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër”, me subjekt zhvillues shoqërinë “Gerti” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
  - a) miratimit të procedurave për heqjen nga fondi pyjor;
  - b) konvertimit të zërit kadastral nga “arë” në “truall” sipas legjislacionit sektorial në fuqi;
  - c) miratimit nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe Këshilli Kombëtar i Arkeologjise;
  - d) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Bashkisë Bulqizë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I  
E D I R A M A

